

NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Drejtori i QNK "Arbnori", Mujë Buçpapaj komenton idetë për Piramidën

Piramida një kopetencë e Qeverisë


faqe 18



Flet për "Nacional" Etleva Sakajeva, përkthyesë dhe gjuhëtare e njohur

"Zotësia" s'është kurrë pa mundësinë

faqe 3



EDITORIAL

Amerikanët kthejnë poezinë "Kujt" në këngë

Nga Sindi Hulbert




Richardson, TX. Në një mënyrë sa prekëse aq edhe simbolike, këto ditë u përkujtua 20-vjetori i arratisjes së poetit shqiptar Gjekë Marinaj nga Shqipëria. "Kujt" që para 20

vjetësh e sollën në Amerikë këtë poet dhe përkthyes të njohur, nuk do të njihen më vetëm si një forcë poetike por dhe si një dramatikë muzikore. Përkthyer në disa gjuhë të huaja, 21 vargjet e poezisë "Kujt" konsiderohen si ikona poetike ...

Faqe 6

Mbresa udhëtimi nëpër rrugën e kombit!

Nga Prof. Sejdi Berisha



Që në fillim dua të them se titulli (s)është metaforik, por, nejtë, nuk di pse ua thash, kur Ju këtë e kuptoni! Ka kohë që kishim biseduar me kri-

jujesit e Tropjës, që ta bëjmë përrurimin e librit të një poeti, nga Gjakova në Tiranë. E kishim këtë dëshirë e këtë mendim edhe për shumë dëshira e qëllime të tjera, cili, sikur pastaj na detyronte edhe ide të tjera. Të cilat, nganjëherë janë rrëqethëse nëse mendojmë në histori...

Faqe 2

Portretizimi i personazheve tek "Lahuta e Malcisë" e Gjergj Fishtës

Fishta, modeli i papërsëritshëm artistik

Studim nga Dea Temali

faqe 12



Në fokus spektakli "Gjashtë personazhe kërkojnë regjisor" "Pirandeloja" e Xhelilit në Tiranë

Kritikë nga Mexhit Prençi

Faqe 4

Në BRENDËSI

"Trioja e përjetshme"

Kritikë nga Pietro Pizuti

faqe 6

"Shitësit e kaosit" të Moikom Zeqos

Studim nga Fatmir Minguli

faqe 16-17

Tregime nga: Idriz Ponari, Qazim D. Shehu, Albert Zholi

faqe 8-11

Dialog me miqtë e mi të letrave

Kritikë nga Prof. Josif Papagjoni

faqe 7

Jeta e diellit tonë

Esse nga Prof. Sahudin Hysenaj

faqe 22

Poezi nga: Sherif Bali, Shahzim Mehmeti, Anton Çefa, Ilire Basha, Mehmet Berisha

faqe 5-14

Kapidani, simfoniku i fundit shkodran

Esse nga Qamil Gjyrezi

faqe 9

Lidershipi

Opinion nga Nazmi Lukaj

faqe 21

Për një politikë kombëtare në qeverisje

Opinion nga Frederik Ruço

faqe 20

MREKULLIA E NATYRES SHQIPTARE!

Cajthiza

Uji Natyral

PCALBANIA
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art

Përkujtohet ne SHBA, 20-vjetori i arratisjes së poetit shqiptar Gjekë Marinaj

Muzikantët amerikanë kthejnë poezinë “Kuajt” në këngë

“Përkthyer në disa gjuhë të huaja, 21 vargjet e poezisë “Kuajt” konsiderohen si ikona poetike më e besueshme e pasqyrimin të realitetit shqiptar gjatë periudhës së diktaturës në Shqipëri. Këto ditë, ai trishtim poetik ka hyrë në mënyrë festive brenda pesë vijave paralele të pentagramit dhe është shpërndarë nëpër katër hapësirat që formohen midis tyre i alternuar në nota muzikore.”

Nga Cindy HULBERT

Richardson, TX. Në një mënyrë sa prekëse aq edhe simbolike, këto ditë u përkujtua 20-vjetori i arratisjes së poetit shqiptar Gjekë Marinaj nga Shqipëria. “Kuajt” që para 20 vjetësh e sollën në Amerikë këtë poet dhe përkthyes të njohur, nuk do të njihen më vetëm si një forcë poetike por dhe si një dramatikë muzikore. Përkthyer në disa gjuhë të huaja, 21 vargjet e poezisë “Kuajt” konsiderohen si ikona poetike më e besueshme e pasqyrimin të realitetit shqiptar gjatë periudhës së diktaturës në Shqipëri. Këto ditë, ai trishtim poetik ka hyrë në mënyrë festive brenda pesë vijave paralele të pentagramit dhe është shpërndarë nëpër katër hapësirat që formohen midis tyre i alternuar në nota muzikore. Sipas Marinajt, nisma e këtij procesi ka filluar vite më parë. Shkruar nga Marinaj në pranverë të vitit 1989 dhe botuar në gazetën Drita më 19 gusht, 1990, poezia “Kuajt” ndërroi formë, nga poetika në muzikë, në vitin 2006, nën kompozimin e artistit shqiptar Gjon Kapedani (1934-2009).

Për më se 4 vjet gjithçka mbeti statike vetëm në letër. Atë që nuk arritën ta bënin këngëtarët dhe muzika shqiptare gjatë jetës së kompozitorit Kapedani, e bënë një grup profesorësh të departamentit të Arteve dhe Humaniteteve, pranë Universitetit të Teksasit në Dallas, pas ndarjes së artistit nga jeta.

Ndonëse projekti kërkoi mbi dy muaj punë dhe një shumë të konsiderueshme monetare për të marrë formën finale, gjithçka u bë e mundur falë mbështetjes largpamëse të UTD-së. Rëndësia që i është dhënë adaptimit të poezisë “Kuajt” në këngë e justifikon plotësisht vendimin e organizatorëve për të përfshirë në këtë projekt profesorët më të specializuar dhe më me eksperiencë që ofron ky universitet.

Teksti është përkthyer në anglisht dhe përshtatur në këngë nga Prof. Frederick Turner. Kontributet e tjera përfshijnë: Prof. Michael McVay, pianist; Prof. Hoyt Neal, tenor; Matt Unkenholz, inxhin-



ier zëri etj. Ky audio-video celebrim i 20-vjetorit të arratisjes të poetit Marinaj nga Shqipëria dhe ardhjes së tij në Amerikë, i është nënshtruar ekspertizës së ilustruesit dhe mjeshtrit të efekteve vizuale Robert L Williams.

I gjithë projektit është mbikëqyrur nga sopranoja e mirënjohur amerikane Prof. Kathryn Evans. Ekspertiza e saj në artin e muzikës ka rezultuar në orkestrimin e një këngë me tone të theksuara dramatike. Si e tillë, kënga “Kuajt” i ofron dëgjuesit mundësinë për të medituar ngjyrat imagjinatave të poetit gjatë peripecive të tij me kontrastet e theksuara të jetës. Evans i ka gjykuar me precizin tingujt që ka dëshiruar; herë revoltues, herë melankolik, e herë delikat duke përdorur një dramatikë të ekuilibruar për t’u dhënë jetë ideve të Marinajt dhe për të shkruar nënkuqtimet e shumta të poezisë së tij brenda parametrave artistik të këngës. Kënga është incizuar në sallat e incizimit dhe filmimit pranë Universitetit të Teksasit në Dallas. Ky kompozim që së shpejti do të ofrohet në CD, mund të shikohet dhe dëgjohet në <http://www.youtube.com/watch?v=ZeueN3KYtLs>, dhe së shpejti në faqen zyrtare elektronike të Marinajt, sponsoruar nga UD, www.marinaj.info, si dhe në faqen elektronike të universitetit www.udt.edu.

Marinaj është diplomuar dy herë nga UTD: në vitin 2006, me Bachelor of Arts in Literary Studies (Magna Cum Laude); në vitin 2008, me Master of Arts in Humanities—Studies in Literature. Ai aktualisht është në vitin e fundit të Doktoraturës, ku është kandidat për Ph.D (Doktor i Filozofisë) gjithashtu në UTD. Në shenjë mirënjohjeje për Amerikën dhe diplomatët e saj në botë, Marinaj dhe i gjithë personeli organizues kanë preferuar që kënga “Kuajt” t’i dedikohet ambasadorit të 21-të Amerikan në ish-Jugosllavi, Warren Zimmerman (1934-2004), i cili pas leximit të poezisë “Kuajt” në pranverë të vitit 1991, i shtrëngoi dorën poetit Marinaj dhe i uroi atij “fat të mirë në Amerikë.” Mirësi kjo që Marinaj duket se nuk i ka munguar gjatë këtyre dy dekadave në Amerikën tonë.

Përktheu nga anglishtja: Miranda Zunga

Për komedinë “Trioja e përjetshme” e Skënder Sherfit

Një vepër që të mrekullon

“Skënder Sherifi është një autor i pashmangshëm i letërsisë bashkëkohore europiane. Shqiptarët kanë shansin ta lexojnë para të gjithëve, dhe të përfitojnë së tepërmi. Belgët janë po aq me fat, sepse banon midis tyre, por ende nuk përfitojnë aq sa duhet.”

Nga Pietro Pizzuti

I dashur mik lexues,

Libri që po mban në duart e tua është një bombë e vërtetë dashurie dhe humori, është një vepër që nuk e klasifikon dot, një vepër atipike sikundër autori i saj, një kryevepër që nuk e merr seriozisht, një pamflet i pacipë që i nxjerr gjuhën teatrit, ashtu si sulmi ndaj një banke me një revole uji në dorë. “Trioja e përjetshme” është një vepër që u jep frymë të re kodeve letrare, apo si një kamikaz i dendur me çokolatë belge që hidhet në erë, në një orgji gjigante, m’u midis Akademisë franceze. Poetin-mik, që është autor i tij, nuk ka nevojë t’jua paraqes ...

Skënder Sherifi është një autor i pashmangshëm i letërsisë bashkëkohore europiane. Shqiptarët kanë shansin ta lexojnë para të gjithëve, dhe të përfitojnë së tepërmi. Belgët janë po aq me fat, sepse banon midis tyre, por ende nuk përfitojnë aq sa duhet. Kjo për ata që kanë veshë të dëgjojnë...

“Trioja e përjetshme” është një vepër letrare sa e papërcaktueshme aq edhe tronditëse. Një dialog i pamundur, i thurur me tel me gjemba e poetikë midis trios së përjetshme, të burrit, gruas dhe dashnorit, që të sjell ndërmend Kastafioen, Kapitenin dhe Poetin, personazhet e pavdekshëm të G. R. Hergé-së. Një subjekt i pashtershëm. Është nga ajo letërsi që të mrekullon. Që nuk të rokanis kokën. Fjalë të thënë troç. Lëng që kullon, copëza që i ndjen në gjuhë. Zëra që i dëgjon. Fjalë që thuhet. Britma.

Gjithçka rrjedh si në modelet e hershme që i kanë dhënë provat, këtu e gjetiu, personazhe që mendojnë, që flasin, që hyjnë në marrëdhënie, që i ikin njëri tjetrit, në një fabul që i tërheq dhe i dirigjon nga maja e hundës. Veçse këtu, ndryshe nga sa ndodh gjetiu, gjithçka është e jashtëzakonshme që në rreshtat e para. Që nga sintaksa që autori e zotëron si një ekuilibrist i vërtetë i fjalës, mjeshtrë i frazës, poet me një intensitet të pazakontë. Dhe kjo deri te përplasjet që lindin e që ndihen nga njëra skenë te tjetra, aty ku nuk e pret, e që thyjnë rrjedhën normale të narracionit.

Trioja e përjetshme lexohet e rilexohet me zë të lartë ! Këtu qëndron sekreti !

Provojeni dhe do të shihni ! Është ngazëlluese ! Të gjallëron si një zhytje në detin Jon në një temperaturë 30° ! Dhe mbi të gjitha, pasi të bindeni vetë, provojeni ta lexoni me shokët tuaj ! Thirrini të gjithë ...

Shijojeni në grup. I ndani rolet dhe i këmbeni midis jush !

Është magjike : Gruaja, Artisti dhe Tjetri do të mësyjnë midis jush, falë jush dhe atyre

që lexojnë me ju ! Ky është teatri, çfarë mrekullie ! Dikush duhet të na e ngjisë në skenë këtë farsë të këndshme njerëzore ! Duhet të na e shfaqin gjatë një mbrëmjeje, përpara se të të zemërohemi dhe ta bëjmë këtë gjë vetë për të gjithë



ata që na duan e na ndjekin. Përpara, pra ! Jepi ! Të guxojmë të ngjisim në skenë poetin që na zbërthen botën ! Pastë jetë të gjatë në letër e në skenë kjo letërsi e gjallë, që ndihet tek mblaçit, tek pi, tek ëndërron... si një orgji grykësie të sketerrshme, tokësore, qiellore. Mish njeriu.

Përktheu nga frëngjishtja:
D. Kokonozi

*Pietro Pizzuti është Dramaturg i shquar, regjisor dhe aktor belg. Pizzuti është një nga 5 emrat më prestigjioz të skenës dhe teatrit belg, me 35 vjet karrierë në top nivel profesional Ai ka disa vepra dramaturgjike të shkruara si autor si dhe të luajtura nëpër skenat belge, pastaj si regjisor i talentuar dhe si aktor.